

<p><i>Acquis</i> së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare) CELEX : 32007L0060, DIREKTIVA 2007/60/KE TË PARLAMENTIT EUROPIAN DHE TË KËSHILLIT, datë 23 Tetor 2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet” (OJ L 288/27, 06.11.2007)</p>		<p>Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) Projekt Ligj “Për Burimet Ujore” Shkalla e përafrimit (një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur Shkalla e Përafrimit e pjesshme</p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Në këtë kolonë shënohet vetëm numri i nenit të instrumentit të <i>acquis</i> së BE-së që përafrohet ose i paragrafit apo nënparagrafit.	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit që i korrespondon numri në kolonën e parë. Sipas rastit, çdo nen mund të copëzohet në paragrafë apo nënparagrafë, duke vendosur secilin në një rresht të veçantë.	Në rastin kur projektaktet që përafrohen janë më shumë se një, atëherë ato numërtohen dhe në këtë kolonë shënohet numri përkatës i referencës	Në këtë kolonë shënohet numri i nenit të projektaktit	Në këtë kolonë shënohet teksti i nenit, ose i pjesëve të nenit, që i korrespondon numri në kolonën e katërt dhe që ka përafrohet kërkesat e nenit të <i>acquis</i> së BE-së në kolonën e dytë.	Në këtë kolonë shënohet shkalla e përafrimit për çdo nen të veçantë.	Në këtë kolonë jepen shënime në lidhje me shkallën e përafrimit. Kur përafrimi nuk është i plotë, jepen arsyet dhe afatet se kur do të bëhet përafrimi i plotë.
Neni 2, pika 1	‘Përmbytja’do të thotë: mbulimi i përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrenjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore kalimtare		Neni 3, pika 50	50. “Përmbytje” është mbulimi i përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrenjtë malorë, nga rrjedha ujore kalimtare e Mesdheut dhe	E plotë	

	Mesdhetare dhe përmytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza.			përmytjet nga deti në zonat bregdetare me përjashtim të përmytjeve nga sistemet e kanalizimeve të ujërave të ndotura.		
Neni 2, pika 2	‘Risku nga përmytjet’ do të thotë: kombinimi i probabilitetit të ngjarjes së përmytjes dhe të pasojave negative të mundshme për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik të shoqëruar më ngjarjen e përmytjes.		Neni 3, pika 63	63. “Risku nga përmytjet” është kombinimi i probabilitetit të ngjarjes së përmytjes dhe të pasojave negative të mundshme për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe veprimtarinë ekonomike që lidhet me ngjarjen e përmytjes.	E plotë	
Neni 1	Qëllimi i kësaj Direktive është të krijojë një kuadër për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmytjet, për reduktimin e pasojave negative për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik lidhur me përmytjet në Komunitet.		Neni 118	Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut nga përmytjet bazohet në parimin e solidaritetit dhe duhet të koordinohet në nivel baseni lumor, me qëllim minimizimin e pasojave negative për shëndetin e njerëzve, mjedisin, trashëgiminë kulturore, veprimtarinë ekonomike dhe infrastrukturën.	E plotë	
Neni 7, pika 4	4. Në interes të solidaritetit, planet e menaxhimit të rrezikut të përmytjeve të krijuara në një Shtet Anëtar nuk do të përfshijnë masat të cilat, me shtrirjen dhe ndikimin e tyre, rrisin në mënyrë të konsiderueshme rreziqet e përmytjeve e sipërme ose të poshtme të vendeve të tjera në të		Neni 118	Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut nga përmytjet bazohet në parimin e solidaritetit dhe duhet të koordinohet në nivel baseni lumor, me qëllim minimizimin e pasojave negative për shëndetin e njerëzve, mjedisin, trashëgiminë kulturore, veprimtarinë ekonomike dhe infrastrukturën.	E plotë	

	<p>njëtin basen lumi ose nën-basen, përveç rasteve kur këto masa kanë qenë të koordinuara dhe është gjetur një zgjidhje e pranueshme midis Shteteve Anëtare në fjalë në kuadër të Nenit 8.</p>					
<p>Neni 4, pika 1</p>	<p>Shtetet Anëtare, për cdo rreth të basenit lumor ose njësi të menaxhimit referuar në Nenin 3(2) (b), ose pjesën e rrethit të basenit lumor ndërkombëtar që shtrihet brënda territorit të tyre, duhet të ndërmarrin vlerësim paraprak të rrezikut të përmytjeve në përmytje me paragrafin 2 të këtij Neni.</p>		<p>Neni 119, pika 1</p>	<p>1. Për çdo basen lumor apo liqenor apo pjesë të një rajoni lumor ndërkufitar që bie në territorin e Shqipërisë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, kryen vlerësimin paraprak të riskut nga përmytjet në përmytje me pikat 2 dhe 3 të këtij neni.</p>	<p>E plotë</p>	<p>Referencat e vendosura në nenin 4, pika 1 e Direktivës janë transpozuar plotësisht nga projektligji. (neni 125, germa (a) dhe neni 119 pika 2 i projektligjit)</p>
<p>Neni 4, pika 2, fjalia e parë</p>	<p>Bazuar në informacionin e nxjerrë në dispozicion ose të gatshëm, sic janë shënimet dhe studimet në zhvillime afat gjatë, në vecanti impaktet e ndryshimit të klimës në dukuritë e përmytjeve, duhet të ndërmerret një vlerësim paraprak i rrezikut të përmytjeve për të parashikuar një vlerësim të rreziqeve potenciale.</p>		<p>Neni 119, pika 2</p>	<p>2. Vlerësimi paraprak i riskut nga përmytjet kryhet bazuar në informacionin e disponueshëm, siç janë të dhënat dhe studimet mbi zhvillimet afatgjata, dhe në veçanti ndikimet e ndryshimeve klimatike në rastin e ndodhjes së përmytjeve.</p>	<p>E plotë</p>	
<p>Neni 4, pika 3</p>	<p>Në rastin e rretheve ndërkombëtare të baseneve lumore, apo njësitë e menaxhimit të përmendur në Nenin 3 (2) (b) të cilat janë ndarë me Shtetet e tjera Anëtare, Shtetet Anëtare sigurojnë që</p>		<p>Neni 119, pika 3</p>	<p>3. Në rastin e rajoneve të baseneve lumore apo liqenore ndërkombëtare, të cilat ndahen me shtetet fqinje, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron shkëmbimin e informacionit me autoritetet</p>	<p>E plotë</p>	

	shkëmbimi i informacioneve përkatëse do të zhvillohet midis autoriteteve kompetente përkatëse.			kompetente përkatëse të atyre shteteve.		
Neni 4, pika 4	Shtetet Anëtare do të përfundojnë vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet deri më 22 Dhjetor 2011.		Neni 119, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton dhe dërgon për miratim në Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit, vlerësimin paraprak të riskut nga përmbytjet në përputhje me këtë nen brenda 2 vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.	E plotë	
Neni 4, pika 2, fjalia e dytë germa (a)	Vlerësimi do të përfshijë të paktën sa vijon: (a) harta të rrethit të basenit të lumit në shkallë të duhur, duke përfshirë kufinj të e baseneve ujore, nën-basene dhe, kur ekzistojnë, zonat bregdetare, duke treguar përdorimin e topografisë dhe të tokës;		Neni 120, pika 1, germa (a)	1. Vlerësimi paraprak i riskut nga përmbytjet përfshin të paktën elementet e mëposhtëm: a) hartat e rajonit të basenit lumor në shkallën e përshtatshme duke përfshirë kufijtë e baseneve lumore, nënbaseneve dhe, kur është rasti zonat bregdetare, si dhe topografinë dhe përdorimin e tokës;	E plotë	
Neni 4, pika 2, fjalia e dytë germa (b)	(b) një përshkrim të përmbytjeve që kanë ndodhur në të kaluarën dhe të cilat kishin ndikime të rëndësishme negative në shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik dhe për të cilat mundësia e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen është ende relevante, duke përfshirë shkallën e tyre të përmbytjes dhe rrugët e bartjes		Neni 120, pika 1, germa (b)	b) përshkrimin e përmbytjeve që kanë ndodhur në të shkuarën dhe që kanë pasur ndikime negative të konsiderueshme për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe veprimtarinë ekonomike, dhe të cilat kanë gjasa të përsëriten në të ardhmen, duke përfshirë shkallën e përmbytjeve, rrugët e përhapjes dhe vlerësimin e ndikimeve negative që kanë sjellë;	E plotë	

	dhe një vlerësim i ndikimeve negative që ato kanë shkaktuar;					
Neni 4, pika 2, fjalë e dytë germa (c)	(c) një përshkrim të përmbytjeve domethënëse që kanë ndodhur në të kaluarën, ku mund të parashikohen pasoja të rëndësishme negative të ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen;		Neni 120, pika 1, germa (c)	c) përshkrimin e përmbytjeve madhore që kanë ndodhur në të shkuarën, ku mund të parashikohen pasoja negative të konsiderueshme për ngjarje të ngjashme në të ardhmen.	E plotë	
Neni 4, pika 2, fjalë e dytë germa (d)	dhe, në varësi të nevojave specifike të Shteteve Anëtare, do të përfshijë: (d) një vlerësim për pasojat e mundshme negative të përmbytjeve të ardhshme për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, duke marrë parasysh sa më shumë çështje të mundshme të tilla si topografia, pozitën e rrjedhave ujore dhe karakteristikat e tyre të përgjithshme hidrologjike dhe gjeomorfologjike, duke përfshirë vendin e përmbytjes si fusha e mbajtjes natyrore, efektiviteti i infrastrukturave artificiale ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet, pozita e zonave të populluara, fushat e aktivitetit ekonomik dhe zhvillimet afatgjata duke përfshirë ndikimet e ndryshimeve klimatike në shfaqjen e përmbytjeve.		Neni 120, pika 2	2. Vlerësimi paraprak i riskut nga përmbytjet, në rastet kur ka një nevojë specifike për këtë, përfshin vlerësimin e pasojave të mundshme negative të përmbytjeve në të ardhmen për shëndetin e njerëzve, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe veprimtarinë ekonomike, duke marrë parasysh sa më shumë të jetë e mundur çështje të tilla si topografia, pozicioni i rrjedhave ujore dhe karakteristikat e tyre të përgjithshme hidrologjike dhe gjeomorfologjike, përfshi edhe zonat e përmbytura si zonat natyrore ujëmbajtëse, efikasitetin e infrastrukturës ekzistuese për mbrojtjen nga përmbytjet të ndërtuara nga njeriu, pozicionin e zonave të populluara, zonat e veprimtarisë ekonomike dhe zhvillimet afatgjata, përfshi ndikimin e ndryshimeve klimatike në ngjarjet e përmbytjeve.	E plotë	

Neni 5, pika 1	Në bazë të një vlerësimi paraprak të rrezikut të përmytjeve të përmendur në Nenin 4, Shtetet Anëtare, për çdo rreth të basenit lumor, ose njësi të menaxhimit të përmendur në Nenin 3 (2) (b), ose pjesë e një rrethi ndërkombëtar të basenit lumor shtrirë brenda territorit të tyre, do të identifikojnë ato fusha për të cilat ato arrijnë në përfundimin se ekzistojnë rreziqe të mundshme të konsiderueshme nga përmytjet ose mund të konsiderohen që kanë mundësi të ndodhin.		Neni 121, pika 1	1. Në bazë të vlerësimit paraprak të riskut nga përmytjet, të miratuar në zbatim të nenit 119 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për çdo rajon të basenit lumor apo pjesë të rajonit të basenit lumor ndërkufitar që bie në territorin e Shqipërisë, identifikon ato zona për të cilat arrihet në përfundimin se ekziston një risk i konsiderueshëm nga përmytjet ose për të cilat gjykohet se përmytjet kanë shumë gjasa që të ndodhin.	E plotë	
Neni 5, pika 2	Identifikimi sipas paragrafit 1 i zonave që i përkasin një rrethi ndërkombëtar të basenit lumor, ose në një njësi të menaxhimit të përmendur në Nenin 3 (2) (b) të përbashkët me një Shtet tjetër Anëtar, do të koordinohet midis Shteteve Anëtare në fjalë.		Neni 121, pika 2	2. Për identifikimin e zonave, sipas pikës 1 të këtij neni, që i përkasin rajonit të basenit lumor ndërkufitar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore koordinon veprimtarinë e saj me shtetin përkatës.	E plotë	
Neni 6, pika 2	Përgatitja e hartave të dëmit nga përmytjet dhe hartat e rrezikut nga përmytjet për zonat e identifikuara sipas Nenit 5, të cilat janë të përbashkëta me Shtetet e tjera Anëtare, do të jetë subjekt i shkëmbimit paraprak të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare në fjalë.		Neni 121, pika 5	5. Përgatitja e hartave të rrezikut nga përmytjet dhe hartave të riskut nga përmytjet për zonat e identifikuara sipas këtij neni, të cilat janë pjesë e një rajoni të basenit lumor ndërkufitar, duhet të realizohet në vijimësi të bashkëpunimit me autoritetet kompetente të shtetit përkatës.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pika 2 (neni 5 i direktivës) është transpozuar nga parashikimet e projektligjit (neni 121, pikat 1 dhe 2)

Neni 6, pika 1	Shtetet Anëtare, në nivelin e rrethit të basenit lumor, ose njësisë së menaxhimit të përmendur në Nenin 3 (2) (b), do të përgatisin harta të rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet, në shkallën më të përshtatshme për zonat e identifikuara sipas Nenit 5 (1).		Neni 122, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bazë të vlerësimit të riskut nga përmbytjet, për çdo rajon të basenit lumor apo pjesë të rajonit të basenit lumor ndërkufitar që bie në territorin e Shqipërisë përgatit hartat e rrezikut nga përmbytjet për zonat e identifikuara sipas pikës 4 të nenit 121 të këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pika 1 e direktivës (neni 5 (1) i Direktivës) është transpozuar nga parashikimet e projektligjit (neni 121 pika 1)
Neni 6, pika 3, germa (a)	Hartat e rrezikut nga përmbytjet do të mbulojnë zonat gjeografike të cilat mund të përmbyten sipas skenarëve të mëposhtme: (a) përmbytjet me skenare me një probabilitet të ulët, ose me ngjarje ekstreme;		Neni 122, pika 2, germa (a)	2. Hartat e rrezikut nga përmbytjet mbulojnë zonat gjeografike që mund të përmbyten sipas skenarëve të mëposhtëm: a) përmbytje me probabilitet të ulët, ose skenarë të ngjarjeve ekstreme;	E plotë	
Neni 6, pika 3, germa (b)	(b) përmbytjet me një probabilitet të mesëm (periudha që ka mundësi të rikthehet ≥ 100 vjet);		Neni 122, pika 2, germa (b)	b) përmbytje me probabilitet mesatar me periudhë përsëritjeje prej ≥ 100 vjetësh;	E plotë	
Neni 6, pika 3, germa (c)	(c) përmbytjet me një probabilitet të lartë, kur është e përshtatshme.		Neni 122, pika 2, germa (c)	c) përmbytje me probabilitet të lartë, kur shihet e përshtatshme.	E plotë	
Neni 6, pika 4, germa (a)	Për çdo skenar të referuar në paragrafin 3 duhet të tregohen elementët e mëposhtëm: (a) shtrirja e përmbytjes;		Neni 122, pika 3, germa (a)	Për çdo skenar të përmendur në pikën 2 të këtij neni, merren parasysh elementet e mëposhtëm: a) shtrirja e përmbytjes;	E plotë	

Neni 6, pika 4, germa (b)	(b) thellësitë e ujit apo të nivelit të ujit, sipas rastit;		Neni 122, pika 3, germa (b)	b) thellësia e ujit ose niveli i ujit, kur është e përshtatshme;	E plotë	
Neni 6, pika 4, germa (c)	(c) kur është e nevojshme, shpejtësia e rrjedhjes apo rrjedhja e ujit përkatës.		Neni 122, pika 3, germa (c)	c) shpejtësia e prurjes apo rrjedha përkatëse e ujit, kur është e përshtatshme.	E plotë	
Neni 6, pika 6	Shtetet Anëtare mund të vendosin që, për zonat bregdetare ku në vend kanë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes, përgatitja e hartave të rrezikut nga përmbytjet do të kufizohet në skenarin e përmendur në paragrafin 3 (a).		Neni 122, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për zonat bregdetare ku niveli i mbrojtjes është i përshtatshëm, mund të përgatisë hartat e rrezikut nga përmbytjet vetëm për skenarin e përmendur në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni.	E plotë	
Neni 6, pika 7	Shtetet Anëtare mund të vendosin që, për zonat ku përmbytja është nga burimet e ujërave nëntokësore, përgatitja e hartave të rrezikut nga përmbytjet do të kufizohet në skenarin e përmendur në paragrafin 3 (a).		Neni 122, pika 5	5. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për zonat ku përmbytjet vijnë nga burimet nëntokësore, mund të përgatisë hartat e rrezikut nga përmbytjet vetëm për skenarin e përmendur në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni.	E plotë	
Neni 6, pika 1	Shtetet Anëtare, në nivelin e rrethit të basenit lumor, ose njësisë së menaxhimit të përmendur në Nenin 3 (2) (b), do të përgatisin harta të rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet, në shkallën më të përshtatshme për zonat e identifikuara sipas Nenit 5 (1).		Neni 123, pika 1	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me autoritete të tjera, në bazë të vlerësimit të riskut nga përmbytjet për çdo rajon të basenit lumor apo pjesë të rajonit të basenit lumor ndërkufitar që bie në territorin e Republikës së Shqipërisë përgatisin hartat e riskut nga përmbytjet për zonat e identifikuara sipas pikës 4 të nenit 121 të këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 6, pika 1 e direktivës (neni 5 (1) i Direktivës) është transpozuar nga parashikimet e projektligjit (neni 121 pika 1)

Neni 6, pika 5, germa (a)	Hartat e rrezikut nga përmbytjet duhet të tregojnë pasojat e mundshme negative të shoqëruara me skenarët e përmbytjeve të përmendura në paragrafin 3 dhe të shprehura në termat e mëposhtme: (a) numri indikativ i banorëve potencialisht të prekur;			2. Hartat e riskut nga përmbytjet tregojnë pasojat e mundshme negative që sjellin skenarët e përmbytjeve të përmendur në pikën 2 të nenit 122 të këtij ligji, të shprehur në: a) numrin tregues të banorëve që mund të preken;	E plotë	
Neni 6, pika 5, germa (b)	(b) lloji i aktivitetit ekonomik të zonës potencialisht të prekur;		Neni 123, pika 2, germa (b)	b) llojin e veprimtarisë ekonomike të zonës që mund të preket;	E plotë	
Neni 6, pika 5, germa (c)	(c) instalimet siç referohet në Aneksin I të Direktivës së Këshillit 96/61/KE të datës 24 Shtator 1996 në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes () e cila mund të shkaktojë ndotje aksidentale në rast të përmbytjeve dhe zonat e mbrojtura potencialisht të prekura të identifikuar në Aneksin IV (1) (i), (iii) dhe (v) të Direktivës 2000/60/KE;		Neni 123, pika 2, germa (c)	c) instalimet që mund të shkaktojnë ndotje aksidentale në rast përmbytjesh dhe zonat e mbrojtura ujore që mund të preken, të identifikuar sipas nenit 38 të këtij ligji;	E plotë	Aneksi IV pika (1) nënpikat (i), (iii) dhe (v) të Direktivës 2000/60/KE, janë përafuar plotësisht nga Neni 38, pika 2, gjerat (a) deri (d)
Neni 6, pika 5, germa (d)	(d) informacione të tjera të cilat Shteti Anëtar i konsideron të dobishme të tilla si të dhëna të zonave ku mund të ndodhin përmbajtje me një përmbajtje të lartë të sedimenteve të transportuara dhe mbetjet e përmbytjeve dhe informacioni për burime të tjera të rëndësishme të ndotjes.		Neni 123, pika 2, germa (ç)	ç) informacione të tjera në përputhje me kërkesat e përcaktuara sipas pikës 4 të nenit 121 të këtij ligji, të tilla si identifikimi i zonave ku mund të ndodhin përmbajtje me përmbajtje të lartë sedimentesh dhe mbetjesh të ngurta të transportuara nga uji dhe	E plotë	

				informacioneve për burime të tjera të konsiderueshme ndotjeje.		
Neni 6, pika 8	Shtetet Anëtare do të sigurojnë që hartat e rrezikut nga përmblytjet dhe hartat e riskut nga përmblytjet janë përfunduar deri më 22 Dhjetor 2013.		Neni 124	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore sigurohet që hartat e rrezikut nga përmblytjet dhe hartat e riskut nga përmblytjet të publikohen brenda 4 vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.	E plotë	
Neni 7, pika 1	Neni 7, pika 1. Në bazë të hartave të referuara në Nenin 6, Shtetet Anëtare do të krijojnë planet e menaxhimit të riskut të përmblytjeve të koordinuara në nivelin e rrethit të basenit të lumit, ose njësi të menaxhimit të përmendur në Nenin 3 (2) (b), për zonat e identifikuar sipas Nenit 5 (1) dhe zonat e mbuluara nga Neni 13 (1) (b) në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni.		Neni 125 fjalia e parë	1. Në bazë të hartave të përmendura në nenet 122 dhe 123 të këtij ligji, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përgatit planet e menaxhimit të riskut nga përmblytjet dhe sigurohet që:	E plotë	
Neni 3, pika 2, Gërma (b)	Neni 3, pika 2, Gërma (b) identifikojnë fusha të caktuara bregdetare ose basene individuale të lumenjve dhe ti caktojnë ata në një njësi të menaxhimit të ndryshme nga ato të caktuara në përputhje me Nenin 3 (1) të Direktivës 2000/60/KE		Neni 125, pika, germa (a)	a) këto plane të përgatiten për çdo rajon të basenit lumor apo pjesë të një rajoni të basenit lumor ndërkufitar që bie brenda territorit të Shqipërisë. Në rast se është e pamundur përgatitja e një plani të vetëm të menaxhimit të riskut nga përmblytjet në nivel rajoni të basenit lumor, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore mund të përgatisë disa plane të menaxhimit të koordinuara në nivel rajoni të basenit lumor;	E plotë	Parashikimet e projektligjit kanë përafëruar plotësisht Nenin 3 (1) të Direktivës 2000/60/KE (neni 12 i projektligjit)
Neni 7, pika 2	Shtetet Anëtare do të përcaktojnë objektivat e duhura		Nenin 125, pika 1, gërma (b)	b) në këto plane të jenë përcaktuar objektivat për	E plotë	

	për menaxhimin e risqeve nga përmbytjet për fushat e identifikuar sipas Neni 5 (1) dhe zonat e mbuluara nga Neni 13 (1) (b), duke u fokusuar në zvogëlimin e pasojave të mundshme negative të përmbytjeve për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, dhe, nëse konsiderohet e përshtatshme, në nismat jo strukturore dhe /ose në uljen e mundësisë së përmbytjeve.			menaxhimin e risqeve nga përmbytjet në zonat e mbuluara nga planet e menaxhimit të risqeve, duke u fokusuar te reduktimi i pasojave të pakthyeshme negative të përmbytjeve për shëndetin e njerëzve, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe veprimtarinë ekonomike, dhe, nëse shihen të përshtatshme, masat jostrukturore ose për reduktimin e probabilitetit të ndodhjes së përmbytjes;		
Neni 7, pika 3, paragrafi i parë	Planet e menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve do të përfshijnë masa për arritjen e objektivave të përcaktuara në përputhje me paragrafin 2 dhe do të përfshijnë përbërësit e përcaktuar në pjesën A të Aneksit.		Nenin 125, pika 1, gërma (c)	c) këto plane të përfshijnë masat për arritjen e objektivave të përcaktuara në përputhje me shkronjën “b” të kësaj pike, dhe elementet e metodologjisë të përcaktuar në përputhje me pikën 3 të këtij neni;	E plotë	
Neni 7, pika 3, paragrafi i dytë	Planet e menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve duhet të marrin në konsideratë aspektet përkatëse të tilla si kostot dhe përfitimet, shtrirjen e përmbytjeve dhe rrugëve të bartjes të përmbytjeve dhe zonat të cilat kanë potencial të mbajnë ujë nga përmbytja, të tilla si vendet natyrore të përmbytjeve, objektivat mjedisore të Neni 4 të Direktivës 2000/60 / KE,		Nenin 125, pika 1, gërma (ç)	ç) këto plane të marrin parasysh edhe aspekte të tjera si: i) kostot dhe përfitimet; ii) shtrirja e përmbytjes, hapësirat ku kalon uji dhe zonat të cilat kanë potencial për të mbajtur ujin, sikurse zonat që përmbysten natyralisht; iii) objektivat mjedisore të përcaktuara në nenet 20, 21 dhe 56 të këtij ligji;	E plotë	Neni 4 i Direktivës 2000/60/ KE është përafuar plotësisht nga ky projektligj (neni 20 pika 1 dhe nenet 21, 22, 23, 24, 25, 26 të projektligjit)

	menaxhimin e tokës dhe të ujit, planifikimi hapësinor, përdorimin e tokës, ruajtjen e natyrës, infrastruktura e lundrimit dhe porteve.			iv) menaxhimin e tokës dhe ujërave; v) planifikimin hapësinor; vi) përdorimin e tokës; vii) ruajtjen e natyrës; viii) lundrimin dhe infrastrukturën portuale;		
Neni 7, pika 3, paragrafi i tretë, fjalia e parë	Planet e menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve duhet të adresojnë të gjitha aspektet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet duke u fokusuar në parandalim, mbrojtje, gatishmëri, duke përfshirë parashikimet e përmbytjeve dhe sistemet e paralajmërit praparak dhe duke marrë në konsideratë karakteristikat e basenit lumor ose nën basenit specifik.		Neni 125, pika 1, germa (d)	d) këto plane të trajtojnë të gjitha aspektet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet duke u fokusuar në: i) parandalim; ii) mbrojtje; iii) gatishmëri, përfshi edhe sistemet e paralajmërit të hershëm; iv) marrjen parasysh të karakteristikave të një baseni apo nënbaseni të caktuar lumor.	E plotë	
Neni 7, pika 3, paragrafi i tretë, fjalia e dytë	Planet e menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve mund të përfshijnë gjithashtu promovimin e praktikave të qëndrueshme të përdorimit të tokës, përmirësimit të ruajtjes së ujit si edhe kontrollimin e përmbytjeve të disa zonave në rastin e një përmbytjeje.		Neni 126, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në raste të caktuara përfshin në planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet: a) promovimin e praktikave të përdorimit të qëndrueshëm të tokës; b) përmirësimin e aftësisë ujëmbajtëse; dhe c) përmbytjen e kontrolluar në zona të caktuara në rast përmbytjesh.	E plotë	

Neni 7, pika 4	Në interes të solidaritetit, planet e menaxhimit të rrezikut të përmytjeve të krijuara në një Shtet Anëtar nuk do të përfshijnë masat të cilat, me shtrirjen dhe ndikimin e tyre, rrisin në mënyrë të konsiderueshme rreziqet e përmytjeve e sipërme ose të poshtme të vendeve të tjera në të njëjtën basen lumi ose nënbasen, përveç rasteve kur këto masa kanë qenë të koordinuara dhe është gjetur një zgjidhje e pranueshme midis Shteteve Anëtare në fjalë në kuadër të Nenit 8.		Neni 126, pika 2	2. Në zbatim të parimit të solidaritetit, planet e menaxhimit të riskut nga përmytjet mund të mos përfshijnë masa të cilat, për nga shkalla dhe ndikimi, rrisin në mënyrë të ndjeshme riskun nga përmytjet në rrjedhën e sipërme apo të poshtme të vendeve të tjera në po të njëjtën basen apo nënbasen lumor, përveçse kur këto masa janë koordinuar dhe është gjetur një zgjidhje e përbashkët me shtetin përkatës, në përputhje me nenin 127 të këtij ligji.	E plotë	Referenca e vendosur në nenin 7, pika 4 e direktivës është transpozuar nga parashikimit e projektligjit. (neni 127, pikat 1, 2, 4, 5
Neni 7, pika 5	Shtete Anëtare duhet të sigurojnë që planet e menaxhimit të riskut të përmytjeve janë përfunduar dhe publikuar deri më 22 Dhjetor 2015.		Neni 125, pika 4 dhe pika 6	4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, miraton planet e menaxhimit të riskut nga përmytjet, brenda 6 vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 6. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon planet e menaxhimit të riskut nga përmytjet.	E plotë	
Neni 10, pika 2	Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë përfshirjen aktive të palëve të interesuara në prodhimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të riskut të		Neni 125, pika 5	5. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përfshin palët e interesuara në hartimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të riskut nga përmytjet.	E plotë	

	përmbytjeve të përmendura në Kapitullin IV.					
Neni 8, pika 1	1.Për rrethet e basenit të lumit, ose njësitë e menaxhimit referuar ne Nenin 3(2) (b), të cilat janë plotësisht në territorin e tyre, Shtetet Anëtare do të sigurojnë që është prodhuar një plan i vetëm ndërkombëtar i menaxhimit të riskut të përmbytjeve, ose një grup të planeve të menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve të koordinuar në nivelin e rrethit të basenit të lumit.		Neni 127, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ndërmerr hapa që synojnë koordinimin e hartimit të një plani të vetëm ndërkufitar për menaxhimin e riskut nga përmbytjet, apo disa planeve të harmonizuara për menaxhimin e riskut nga përmbytjet në nivelin e rajonit të basenit lumor ndërkufitar, me autoritetet kompetente të shteteve fqinje, për pjesën e rajonit të basenit lumor ndërkufitar që bie në territorin e Shqipërisë.	E plotë	
Neni 8, pika 2	2. Kur një rreth ndërkombëtar i basenit të lumit, ose njësia e menaxhimit të përmendur në Nenin 3 (2) (b), bie tërësisht brenda Komunitetit, Shtetet Anëtare do të sigurojnë koordinimin me qëllim të prodhimit të një plani të vetëm ndërkombëtar të menaxhimit të riskut nga përmbytjet, ose një set të planeve të menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve të koordinuara në nivel ndërkombëtar të basenit lumor. Aty ku këto plane nuk janë prodhuar, Shtetet Anëtare do të prodhojnë planet e menaxhimit të rrezikut të përmbytjeve që mbulojnë të paktën pjesët e		Neni 127, pika 2	2. Në rast se hartimi i një plani të vetëm ndërkufitar për menaxhimin e riskut nga përmbytjet, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet që mbulojnë të paktën pjesën e rajonit të menaxhimit të basenit lumor apo liqenor ndërkufitar që bie në territorin e Shqipërisë, duke e koordinuar për aq sa është e mundur në nivel rajoni të menaxhimit të basenit lumor apo liqenor ndërkufitar.	E plotë	

	basenit ndërkombëtar të lumit që bie brenda territorit të tyre, sa më shumë të jetë e mundur të koordinuara në nivel të rrethit ndërkombëtar të basenit lumor.					
Neni 8, pika 4	4. Planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet e përmendura në paragrafët 2 dhe 3 do të plotësohen, kur konsiderohet e përshtatshme nga vendet që ndajnë një nën-basen, me plane më të detajuara të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, të koordinuara në nivelin e nën-baseneve ndërkombëtare.		Neni 127, pika 3	3. Planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur konsiderohet e përshtatshme nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe shteti me të cilin ndajnë të njëjtin nënbasen, mund të plotësohen me plane të tjera të detajuara për menaxhimin e riskut nga përmbytjet në nivelin e nënbasenit ndërkufitar.	E plotë	
Neni 8, pika 5	5. Kur një Shtet Anëtar identifikon një çështje e cila ka një ndikim në menaxhimin e rreziqeve të përmbytjeve të ujit të tij dhe këtë çështje nuk mund të zgjidhet nga ai Shtet Anëtar, mund të raportojë çështjen në Komision dhe çdo Shtet tjetër Anëtar të interesuar dhe mund të bëjë rekomandime se si mund të zgjidhet çështje. Komisioni do të përgjigjet çdo njoftimi ose rekomandimi nga Shtetet Anëtare brenda një periudhe prej gjashtë muajsh.		Neni 127, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në rast se identifikon një problematikë që ndikon në menaxhimin e risqeve nga përmbytjet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe konstaton se zgjidhja e kësaj problematike nuk mund të zgjidhet vetëm përmes saj, informon për këtë problematikë Këshillin e Ministrave, së bashku me rekomandimet për zgjidhje. Këshilli i Ministrave, merr masat për zgjidhjen e problematikës në konsultim me shtetet fqinje të interesuara.	E plotë	
Neni 9, paragrafi i parë	Shtetet anëtare duhet të marrin hapat e duhur për të koordinuar zbatimin e kësaj Direktive dhe		Neni 128	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ndërmerr hapat e nevojshme për të koordinuar	E plotë	Neni 4 i Direktivës 2000/60/KE, është transpozuar plotësisht nga

	atë të Direktivës 2000/60/KE duke u përqëndruar në mundësitë për përmirësimin e efikasitetit, shkëmbimin e informacionit dhe për të arritur sinergji dhe përfitime të përbashkëta duke pasur parasysh objektivat mjedisore të përcaktuara në Nenin 4 të Direktivës 2000/60/KE. Në veçanti:			veprimtaritë e hartimit të planeve të menaxhimit të riskut nga përmytja me planet e menaxhimit të baseneve lumore, me fokus përmirësimin e efikasitetit, shkëmbimin e informacionit dhe sigurimin e sinergjive dhe përfitimeve të përbashkëta, duke pasur parasysh objektivat mjedisore të përcaktuara në nenet 20, 21 dhe 56 të këtij ligji, veçanërisht për sa më poshtë:		parashikimet e projektligjit. (neni 20 pika 1, nenet 21 22 23 24 25 26 të projektligjit)
Neni 9 pika 1	1. zhvillimi i hartave të para të rrezikut të përmytjeve dhe hartat e riskut nga përmytjet dhe rishikimet e tyre të mëvonshme të referuara në Nenet 6 dhe 14 të kësaj Direktive do të bëhet në mënyrë të tillë që informacioni që ato përmbajnë është në përputhje me informacionin përkatës të paraqitur në bazë të Direktivës 2000 / 60/KE. Ata do të koordinohen me, dhe mund të integrohen në, rishikimet e parashikuara në Nenin 5 (2) të Direktivës 2000/60/KE;		Neni 128, germa (a) dhe (b)	a) përgatitjen e hartave të para të rrezikut nga përmytjet dhe hartave të riskut nga përmytjet, si dhe rishikimi dhe publikimi i tyre, kryhet në përputhje me nenet 122, 123, 124 dhe pikën 2 të nenit 129 të këtij ligji, në mënyrë të tillë që informacioni që ata përmbajnë të jetë në përputhje me informacionin e paraqitur në planet e menaxhimit të baseneve lumore në përputhje me këtë ligj; b) përgatitja e hartave të rrezikut nga përmytjet dhe hartave të riskut nga përmytjet mund të koordinohet dhe të përfshihen në rishikimet e planeve të menaxhimit të basenit lumor, në përputhje me pikën 7 të nenit 53 të këtij ligji;	E plotë	Nenin 14 i Direktivës 2000/60/KE është përafshuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 54 i projektligjit) Nenin 5 (2) i Direktivës 2000/60/KE është përafshuar plotësisht nga parashikimet e projektligjit. (neni 27 pika 2 e projektligjit)
Neni 9, pika 2	2. zhvillimi i planeve të para të menaxhimit të riskut të		Neni 128, germa (c)	c) hartimi i planeve të para të menaxhimit të riskut nga	E plotë	Neni 13(7) i Direktivës 2000/60/KE është përafshuar

	përmbytjeve dhe rishikimet e tyre të mëvonshme të referuara në Nenet 7 dhe 14 të kësaj Direktive do të kryhen në koordinim me, dhe mund të integrohen, në rishikimet e planeve të menaxhimit të basenit të lumit të parashikuara në Nenin 13 (7) të Direktivës 2000/60/KE;			përmbytjet, në përputhje me nenet 125 dhe 128 të këtij ligji, dhe rishikimet e tyre vijuese në përputhje me nenin 135 të këtij ligji, koordinohen dhe mund të përfshihen në rishikimin e planeve të menaxhimit të baseneve lumore të parashikuara në pikën 7 të nenit 53 të këtij ligji;		plotësisht nga parashikimet e projektligjit. (neni 53 pika 6 e projektligjit)
Neni 9, pika 3	3. përfshirja aktive e të gjitha palëve të interesuara sipas Nenit 10 të kësaj Direktive do të koordinohet, sipas rastit, me përfshirjen aktive të palëve të interesuara sipas Nenit 14 të Direktivës 2000/60/KE.		Neni 128, germa (ç)	ç) përfshirja aktive e të gjitha palëve të interesuara sipas këtij neni të koordinohet, sipas rastit, me përfshirjen e palëve të interesuara për hartimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të baseneve lumore në përputhje me nenin 53 të këtij ligji.	E plotë	Nenin 14 i Direktivës 2000/60/KE është përfruar plotësisht nga parashikimet e projektligjit (neni 54 i projektligjit)
Neni 10, pika 1	Në përputhje me legjislacionin në fuqi të Komunitetit, Shtetet Anëtare do të vënë në dispozicion të publikut të vlerësimin paraprak të riskut nga përmbytjet, hartat e rrezikut të përmbytjeve, harta e riskut nga përmbytjet dhe planet e menaxhimit të riskut të përmbytjeve.		Neni 119, pika 5. Neni 124 Neni 125, pika 6	119/5. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon vlerësimin paraprak të riskut nga përmbytjet. 124. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore sigurohet që hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet të publikohen brenda 4 vitesh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 125/6. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore publikon planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet.	E plotë	
Neni 14, pika 1	1. Vlerësimi paraprak i riskut nga përmbytjet, apo vlerësimi dhe vendimet e		Neni 129, pika 1	1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që vlerësimi paraprak i riskut nga	E plotë	

	përmendura në Nenin 13 (1), do të rishikohen, dhe nëse është e nevojshme përditësohen, deri më 22 Dhjetor 2018 dhe çdo gjashtë vjet pas kësaj.			përmbytjet të rishikohet dhe, nëse është e nevojshme, të përditësohet brenda 8 vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe çdo 6 vjet në vijim.		
Neni 14, pika 2	2. Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e riskut nga përmbytjet do të rishikohen, dhe nëse është e nevojshme përditësohen, deri më 22 Dhjetor 2019 dhe çdo gjashtë vjet pas kësaj.		Neni 129, pika 2	2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që hartat e rrezikut nga përmbytjet të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, të përditësohen brenda 9 vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe çdo 6 vjet në vijim.	E plotë	
Neni 14, pika 3	3. Plani/et e menaxhimit të riskut nga përmbytjet do të rishikohen, dhe nëse është e nevojshme përditësohen, duke përfshirë komponentët e përcaktuar në pjesën B të Aneksit, deri më datë 22 Dhjetor 2021 dhe çdo gjashtë vjet pas kësaj.		Neni 129, pika 3	3. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, të përditësohen, brenda 12 vitesh pas hyrjes në fuqi të ligjit për burimet ujore, dhe çdo 6 vjet në vijim.	E plotë	
Neni 14, pika 4	4. Ndikimi i mundshëm i ndryshimeve klimatike mbi dukurinë e përmbytjeve do të merren parasysh në shqyrtimet e përmendura në paragrafët 1 dhe 3.		Neni 129, pika 4	4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore siguron që rishikimet dhe përditësimet e përmendura në pikat 1 – 3 të këtij neni të marrin parasysh ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike në ngjarjet e përmbytjeve	E plotë	
Shtojca e Direktivës	Planet e menaxhimit të riskut nga Përmbytjet		Neni 120, pika 4, Neni 121, pika 4 Neni 125, pika 3	Neni 120, pika 4 Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton elementet e metodologjisë për kryerjen e vlerësimit paraprak të riskut nga	E pjesshme	Neni 120, pika 4, Neni 121, pika 4 dhe Neni 125, pika 3, përcaktojnë bazën ligjore për nxjerrjen e aktit nënligjor i cili do të transpozohet

				<p>përmbytjet, të hartuar sipas pikës 3 të këtij neni, brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p> <p>Neni 121, pika 4 Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton zonat për të cilat ekziston risk i konsiderueshëm nga përmbytjet ose për të cilat gjykohet se përmbytjet kanë shumë gjasa që të ndodhin dhe metodologjinë për përgatitjen e hartave të rrezikut nga përmbytjet dhe hartave të riskut nga përmbytjet, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, brenda 6 muajsh nga miratimi i vlerësimit paraprak të riskut nga përmbytja sipas pikës 4 të nenit 119.</p> <p>Neni 125, pika 3 Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit miraton elementet e metodologjisë për hartimin e planeve të menaxhimit të riskut nga përmbytjet, të përcaktuar sipas pikës 3 të këtij neni, brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p>		<p>plotësisht shtojcën e Direktivës</p>
--	--	--	--	--	--	---